

## DEKLARATË

**Për rastin e përfaqësimit të shtetasës P.R. për akuzën “*Drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt*”.**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Penale, ka mbajtur në shqyrtim çështjen penale me të pandehur shtetasen P.R., akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal “*Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt*”, konkretisht automjetet i tipit motor, pa targa dhe pa leje drejtimi i cili ka përbërë dhe një provë materiale të sekuestruar.

Avokatët e CLE-së kanë bërë mbrojtjen ligjore të shtetasës së komunitetit Rom duke i vërtetuar Gjykatës:

1. Gjendjen e penduar të së pandehurës;
2. Arsyet ekonomike, familjare dhe sociale;
3. Moshën e saj;
4. Faktin që e pandehura figuron pa procedim penal të mëparshëm.

Duke mbajtur në konsideratë këto arsye Gjykata ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të së pandehurës P.R për kryerjen e veprës penale të “*Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt*” dhe e dënon atë me 1 (një) muaj dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim;
2. Në zbatim të nenit 406 të KPC, pas uljes së dënimit me 1/3, e pandehura dënohet me 1 muaj burgim;
3. Bazuar në nenin 63 të Kodit Penal, Gjykata urdhëron pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim si mësipër duke e zëvendësuar atë me detyrimin e të pandehurës të përmbushë një punë në interes publik.

**Në lidhje me motorin i cili përbënte një provë materiale të sekuestruar, Gjykata ka vendosur kthimin e mjetit të së pandehurës.**